

Nr.regj. 14823/2012

**GJYKATA KOMUNALE PËR KUNDËRVAJTJE NË PRISHTINË**, duke vendosur në procedurën për kundërvajtje kundër të pandehurit Salih Mustafa nga Prishtina, për kundërvajtje nga neni 10 lidhur me nenin 5.1 dhe 6.1.4 të ndëshkuar me nenin 17 parag. 1.4 të Ligjit për Deklarimin, Prejardhjen dhe Kontrollin e Pasurisë dhe të Dhuratave të Zyrtarëve të Lartë Publik, Nr. 04/L-050, në bazë të nenit 73,74,195,199 dhe nenit 9 të Ligjit mbi Kundërvajtjet GZK 23/79, me datë **28.12.2012** merr këtë:

## **A K T V E N D I M**

**I PANDEHURI: Salih Jahja Mustafa**, i lindur më 01.01.1972 në Prishtinë, ku edhe jeton, me vendbanim në rrugën "Isa Kastrati", me shkollim superior, me profesion oficer ushtarak, i papunë, i martuar, babë i dy fëmijëve, i gjendjes së mesme ekonomike,

### **Ë s h t ë P ë r g j e g j ë s**

**Sepse**, duke qenë Zyrtar i Lartë Publik, në pozitë të Këshilltarit Politik në Ministrinë e Forcës së Sigurisë së Kosovës, nuk e ka bërë deklarimin e pasurisë brenda afatit prej 30 ditësh pas largimit nga funksioni me datë 02.03.2012

- **me çka ka kryer kundërvajtje nga neni 10 lidhur me nenin 5.1 dhe 6.1.4 të ndëshkuar me nenin 17 parag. 1.4 të Ligjit për Deklarimin, Prejardhjen dhe Kontrollin e Pasurisë dhe të Dhuratave të Zyrtarëve të Lartë Publik**, andaj të pandehurit për këtë kundërvajtje i shqiptohet,

## **D Ë N I M I**

**Me gjobë në shumë prej 200 € (dyqind euro euro)**, të cilën shumë i pandehuri është i obliguar ta paguaj në afat prej 15 ditësh, pasi që ky aktvendim të merr formë e prerë, në llogarinë e të hyrave gjyqësore të KGJK-së No.1000 4300 7000 0518. Pagesa bëhet në ndonjë agjenci për mbledhjen e të hyrave-bankë, përmes urdhërpagesës së plotësuar nga Gjykata. Nëse gjobën e shqiptuar nuk e paguan në afatin e dhënë, e njëjta do të zëvendësohet me dënim burgimi në kohëzgjatje prej **13 ditësh**, duke llogaritur nga 15 Euro për një ditë burgimi.

Shpenzime të procedurës nuk ka pasur, kurse në emër të paushallit gjyqësor i pandehuri është i obliguar të paguaj shumë prej **5 Euro** në shërbimin e arkës së gjykatës.

Nga një kopje e këtij aktvendimi i dërgohet parashtruesit të kërkesës dhe të pandehurit.

## **A r s y e t i m**

**Agjencia Kundër Korrupsionit në Prishtinë**, i parashtrori kësaj gjykate Kërkesën Nr. 01-1603/2012 me datë 02.05.2012 për fillimin e procedurës kundërvajtëse kundër të pandehurit të lartshënuar për kundërvajtjen e precizuar si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Në bazë të kërkesës së parashtruar, gjyqtarja filloi procedurën kundërvajtëse, mori në pyetje të pandehurin i cili në mbrojtjen e vet deklaroi se e pranon kundërvajtjen e cila i vihet në barrë, duke shtuar se vërtetë me datë 02.03.2012 kishte dhënë dorëheqjen para ministrit të Ministrisë së FSK e cila i ishte aprovuar dhe po atë ditë ka qenë i njoftuar nga kabineti i Ministrit, sekretarja e ministrit për obligimin e deklarimit të pasurisë, por siç thekson ndonëse ka qenë në dijeni për këtë obligim ligjor, i njëjti ka menduar se njëherë veç e kishte plotësuar një lloj formulari të KFOR-it për të kaluarën e tij personale duke menduar se është i mjaftueshëm. Në vazhdim thekson se ishte interesuar në AKK, kishte kontaktuar dy herë përmes telefonit

DPK/OMP	03-181/2013
02	28-01-2013

me zyrtarin kontaktues dhe në fund pa i ditur pasojat e kishte anashkaluar çështjen e deklarimit të pasurisë, por siç thekson jo me qëllim të shmangies së qëllimshme të deklarimit të pasurisë.

Për të vërtetuar gjendjen e plotë dhe të drejtë faktike, gjyqtarja dëgjoi edhe parashtruesin e kërkesës, në cilësi të dëshmitarit, i cili sqaroi se në kërkesë është shënuar gabimisht neni 8 i Ligjit 04/L-050 në vend të të cilit do duhej të jetë neni 10 i të njëjtit ligj të cilin i pandehuri nuk e ka respektuar dhe nuk e kishte përmbushur obligimin ligjor për deklarim të pasurisë pas largimit nga funksioni. Mëtej, dëshmitari sqaroi se në përgjigjen që i kishte dhënë zyrtarit kontaktues në FSK me datë 28.03.2012 siç shihet edhe në korrespondenca elektronike e bashkangjitur, kishte precizuar afatin prej 30 ditësh për deklarim të pasurisë pas largimit nga funksioni. Ndërsa zyrtari kontaktues sqaroi se me datë 02.03.2012 të gjithë zyrtarëve të lartë në FSK, përfshirë edhe Sali Mustafën, u kishte dërguar njoftimin për deklarim të rregullt të pasurisë, pa qenë menjëherë në dijeni për largimin e Salih Mustafës nga funksioni i këshilltarit politik.

Nga të dhënat në kërkesë, vlerësimi i deklaratës së të pandehurit, dëshmitarëve, shqyrtimi i provës materiale dhe i shkresave të tjera të lëndës, administrimi i secilës veç e veç dhe të gjitha së bashku, gjyqtarja në masë të mjaftueshme vërtetoi gjendjen e plotë dhe të drejtë faktike, ekzistimin e veprës kundërvajtëse dhe përgjegjësisë së të pandehurit për këtë kundërvajtje meqë i njëjti siç pohon ka qenë plotësisht në dijeni për obligimin e deklarimit të pasurisë pas largimit nga funksioni, por këtë obligim e ka anashkaluar duke mos i kushtuar rëndësinë e duhur, duke menduar me neglizhencë se dalja nga funksioni nuk mund ta obligojë për deklarim të pasurisë. ndonëse ligjërisht ka pasur afat prej 30 ditësh për ta përmbushur këtë obligim, andaj gjyqtarja për kundërvajtjen e kryer në aplikim të nenit 9 të LK i shqiptoi dënimin nën minimumin e paraparë ligjor.

Gjatë shqiptimit të dënimit gjyqtarja pati parasysh rrethanat nga neni 7 i LK në të cilat është kryer kundërvajtja dhe sipas peshës së kundërvajtjes e shkallës së përgjegjësisë së pandehurit, e duke vlerësuar edhe faktin se është i papunë, të cilat i konsideroi si rrethana lehtësuese, njëjtin e dënoi me dënim me gjobë të zbutur të precizuar si në dispozitiv të këtij aktvendimi, me bindje se edhe me një gjobë të tillë do të arrihet qëllimi i ndëshkimit dhe se i pandehuri në të ardhmen do të shmanget nga kryerja e ndonjë kundërvajtjeje të natyrës së tillë apo të ngjashme.

Me sa u tha më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

**U VENDOS NË GJYKATËN KOMUNALE PËR KUNDËRVAJTJE NË PRISHTINË**  
 Nr.regj.14823/2012, datë 28.12.2012

Gjyqtarja  
 Suzana Çerkini

**KËSHILLA JURIDIKE:** Kundër këtij aktvendimi pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në afat prej 8 ditësh Gjykatës së Lartë për Kundërvajtje në Prishtinë, nga data e pranimit të njëjtit nëpërmjet kësaj gjykate, pa taksa.